

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

**Për Auditimin e Fondeve të Përfituara dhe të Shpenzuara në
Fushatën Zgjedhore të Kuvendit 2017 nga**

Partia Demokratike e Shqipërisë

Angazhuar nga: Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve



AS-Audit Services sh.p.k

Adresa: Rr. "KOSOVAREVE", Nd.35, H.2, Ap.7
Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tiranë
Mobil: 069 20 99 204
Tel/fax: (04) 2 430 084
E-mail: as-auditservices@hotmail.com
afirim.suli@hotmail.com

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4 Tiranë, Shqipëri

I. Raport mbi Auditimin e Pasqyrës Financiare për Qëllime Specifike "Fondet e Përfituara dhe të Shpenzuara për Fushatën Zgjedhore të Kuvendit 2017"

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrën financiare për qëllime specifike "Fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të kuvendit 2017", të Partisë Demokratike të Shqipërisë, më 25 Shtator 2017. Pasqyra financiare është përgatitur nga drejtimi bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimprurese (SKK për OJF-të. Ajo përfaqëson një raportim financiar të ndërmjetëm në periudhën 1 janar-25 shtator 2017 për të përmbushur kërkesat specifike të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së).

Sipas opinionit tonë, pasqyra financiare bashkëlidhur "Fondet e përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të kuvendit 2017" të Partisë Demokratike të Shqipërisë, më 25 Shtator 2017, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimprurese (SKK për OJF-të) dhe kërkesave specifike të legjislacionit zgjedhor.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-805). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditime të tilla.

Ne jemi të pavarur nga Partia Politike në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare specifike, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrës financiare në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimprurese (SKK për OJF-të), kërkesat e ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike" i ndryshuar, udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrës financiare që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Partisë.

Përgjegjësitë e Audituesit

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion mbi këtë pasqyrë financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-805). Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyra financiare nuk ka anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrën financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrën financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit.

Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrës financiare në mënyrë që të planifikojë procedura auditimi të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion në lidhje me efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës financiare.

II. Raport mbi Kërkesa të Tjera Ligjore dhe Rregullatore

Ky seksion i raportit trajton përgjegjësitë e tjera të raportimit në raportin e audituesit mbi pasqyrën financiare, përveç përgjegjësiave të audituesit sipas SNA-805.

Këto përgjegjësi të tjera raportuese janë të përcaktuara në termat e kontratës dhe burojnë nga Kodi zgjedhor, ligji nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike" i ndryshuar dhe udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Në përmbushje të këtyre kërkesave subjekti zgjedhor Partia Demokratike ka hartuar pasqyrën "Fondet e Përfituara dhe të Shpenzuara për Fushatën Zgjedhore të Kuvendit 2017" siç tregohet në tabelën vijuese:

"Fondet e Përfituara dhe të Shpenzuara për Fushatën Zgjedhore të Kuvendit 2017"

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Periodha e raportimit 1 Janar-25 Shtator 2017)
A	Të ardhurat :	
1	Të ardhura nga tarifat e antarësimit	-
2	Të ardhura nga donacionet dhe kontribute vullnetare	-
	Donacion në mjete monetare	-
	Donacion në natyrë, kohë televizive, qera etj	22,889,253
3	Të ardhura nga grantet, qeveritare, agjenci të tjera	108,157,230
4	Të ardhura nga investimet apo dhurimet	-
5	Tarifat për shërbimet	-
6	Të ardhura nga aktivitetet tregtare	-
7	Të ardhura të tjera	-
	Totali i të ardhurave	131,046,483
B	Shpenzimet-Aktiviteti-Fushata zgjedhore për Kuvendin 2017	
1	Shpenzime materiale promovionale	4,036,000
2	Shërbim foni, stage, ndriçim etj.	10,000,000
3	Trasmetime live	16,000,000
4	Trasmetim spotesh, reklama etj	39,040,736
5	Inventar me qera (përfshirë transportin etj.)	9,800,000
6	Qera ambjenti për Z.Elektorale (vleresim E.F)	1,738,853
7	Konsulencë vendase dhe e huaj	16,602,878
8	Të tjera	-
	Shuma-Aktivitetit	97,218,466

Nga evidenca e auditimit rezulton se hartimi i pasqyrës financiare të mesiperme mbështetet në dokumenta justifikues dhe në regjistrime kontabel të mbajtuara sipas kërkesave të SKK për OJF-të. Ajo është pjese integrale e pasqyrës së aktivitetëve dhe ndarja e të ardhurave dhe

shpenzimeve sipas destinacionit, midis aktivitetit normal të funksionimit të partisë dhe aktivitetit të fushatës zgjedhore është bërë nga drejtimi financiar i partisë dhe është audituar nga ne.

Të ardhurat analitike të marra nga buxheti i shtetit janë arketuar në datat dhe shumat e mëposhtëme:

Nr	Data e transaksionit	Pershkrimi veprimit	Shuma
Raiffeisen Bank			
	23-Feb-17	Ministria e financave fond	111,679
	11-Apr-17	Fondi për zgjedhjet MF	27,274,533
	21-Apr-17	Fondi për zgjedhjet MF	20,000,000
	15-Jun-17	Fondi për zgjedhjet MF	20,771,018
IC.Bank			
	11-Apr-17	Fondi për zgjedhjet MF	2,000,000
	21-Apr-17	Fondi për zgjedhjet MF	38,000,000
Shuma e financimit buxhetor			108,157,230

Në këtë zë të ardhurash janë përfshirë të gjitha financimet buxhetore të marra nga 1 janari deri në 25 shtator 2017, pa i dalluar se perse janë dhenë, si fond vjetor, diferenca apo si fond për fushatën zgjedhore. Kjo për faktin se mbulimi i shpenzimeve të fushatës bëhet nga të gjitha burimet, si nga ato të marra për fushatën ashtu dhe nga burimet e tjera të ligjshme. Për të krahasuar nëse shuma e përfituar nga partia politike, sipas Kodit Zgjedhor, është më e madhe se shuma e dokumentuar si e shpenzuar për financimin e fushatës zgjedhore, duhen marrë të dhënat përkatëse.

Përveç financimeve buxhetore subjekti zgjedhor ka pasqyruar dhe donacione dhe kontribute në natyrë si më poshtë:

Nr	Fatura Datë	Donatorët	Shuma
292	16-06-17	Media Vision sh.a	700,000
40	14-06-17	TOP CHANNEL sh.a	10,351,200
651	20-06-17	TOP CHANNEL sh.a	9,000,000
654	21-06-17	TOP CHANNEL sh.a	1,099,200
Extra		Qeraja e zyrave elektorale-grup(vleresim i E.F)	1,738,853
Totali donacione			22,889,253

Donacionet nga kompanitë e mediave janë të dokumentuara me faturë tatimore dhe në secilin prej tyre është ndarë shërbimi me pagesë dhe shërbimi falas i kohës televizive.

Donacionet në natyrë për përdorimin e zyrave elektorale bazohet në vleresimin e Eksperteve Financiar dhe është regjistruar në të ardhura dhe shpenzime me këtë dokument dhe jo nga kontratat dhe faturat me të cilat dokumentohet një donacion.

Shpenzimet analitike të destinuar për fushatën zgjedhore, të dokumentuara me fatura blerje dhe aktvlerësime nga ekspertët financiarë paraqitën si më poshtë:

Fatura		Furnitori	Pershkrimi shërbimit	Data e Pageses	Shuma
Nr	Datë				
	13-Apr-17	Barner & Thornburg LLP	Konsulencë	13-Apr-17	6,385,000
1225	28-04-17	CLEAR PATH STRATEGIES LLC	Konsulencë	8-May-17	1,820,109
	13-Apr-17	Barner & Thornburg LLP	Konsulencë	12-May-17	6,200,000
73	25-05-17	Ora sh.a	Trasmetim live	25-May-17	4,000,000
385	25-05-17	Besnik Baku-PF	Materiale propagandistike	25-May-17	3,036,000
53	25-05-17	ASLV sh.p.k	Sherbim foni,stage,ndricim etj	25-May-17	3,000,000
898	25-05-17	SCREEN AD sh.p.k	Sherbim foni,stage,ndricim etj	29-May-17	2,000,000
440	25-05-17	DIXHI PRINT - AL	Materiale me qera (karrike,baner,transport etj)	25-May-17	4,800,000
596	07-06-17	ABC News sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	7-Jun-17	1,338,700
669	08-06-17	TV Klan sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	12-Jun-17	1,337,900
40	14-06-17	TOP CHANNEL sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	15-Jun-17	3,543,600
292	16-06-17	Media Vision sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	16-Jun-17	700,000
687	19-06-17	TV Klan sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	20-Jun-17	1,447,667
400	19-06-17	Fokus Media News sh.p.k	Trasmetim spotesh publicitare	20-Jun-17	1,365,095
50	19-06-17	OLS ABAZI PF	Materiale propagandistike	19-Jun-17	1,000,000
	19-Jun-17	MURPHY VOGEL ASKEW RIELLY LLC	Konsulencë	19-Jun-17	609,169
	20-Jun-17	MURPHY VOGEL ASKEW RIELLY LLC	Konsulencë	20-Jun-17	1,588,600
651	20-Jun-17	TOP CHANNEL sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	20-Jun-17	4,894,300
603	20-06-17	ABC News sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	20-Jun-17	1,639,344
122	20-06-17	Ora sh.a	Trasmetim live	22-Jun-17	3,000,000
124	21-06-17	Ora sh.a	Trasmetim live	27-Jun-17	3,000,000
66	21-06-17	ASLV sh.p.k	Sherbim foni,stage,ndricim etj	22-Jun-17	2,500,000
593	21-06-17	DIXHI PRINT - AL	Materiale me qera(karrike baner transport etj)	22-Jun-17	2,500,000
654	21-06-17	TOP CHANNEL sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	22-Jun-17	421,200
613	23-06-17	ABC News sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	27-Jun-17	692,930
409	23-06-17	Fokus Media News sh.p.k	Trasmetim spotesh publicitare	27-Jun-17	509,600
128	23-06-17	Ora sh.a	Trasmetim live	22-Jun-17	3,000,000
130	27-06-17	Ora sh.a	Trasmetim live	30-Jun-17	3,000,000
611	27-06-17	DIXHI PRINT - AL	Materiale me qera(karrike,baner,transport etj)	30-Jun-17	2,500,000
69	27-06-17	ASLV sh.p.k	Sherbim foni,stage,ndricim etj	30-Jun-17	2,500,000
Donacione, zbritje në faturë dhe vlerësime					
292	16-06-17	Media Vision sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	16-06-17	700,000
40	14-06-17	TOP CHANNEL sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	14-06-17	10,351,200
651	20-06-17	TOP CHANNEL sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	20-06-17	9,000,000
654	21-06-17	TOP CHANNEL sh.a	Trasmetim spotesh publicitare	21-06-17	1,099,200
Extra	Totale	Qeraja e zyrave-grup(vleresim i E.F)	Qera e zyrave Elektorale		1,738,853
Shuma					97,218,466

Subjekti zgjedhor në funksion të realizimit të fushatës ka kontraktuar shoqeri tregtare dhe persona fizik për realizimin e shërbimeve të parashikuara, të cilat kanë qënë furnizime

sherbimesh komplekse që përfshinin burimet njerezore, materialet e përdorura, transportin, etj.

Këto sherbime i janë faturuar subjektit zgjedhor me fatura të regullta blerje në shuma totale pa i individualizuar sipas aktiviteteve në kohën kur ato kanë ndodhur, mungesë e cila penalizon furnizuesin e shërbimit dhe krijon veshtirësi në kalkulimet e kostove për secilin aktivitet, ashtu siç e kërkojnë udhëzimet e KQZ-së

Jane njohur si shpenzim i fushates dhe koha televizive qe eshte perfituar falas nga shoqërite e mediave të cilat janë dokumentuar me fatura blerjeje. Por jo të gjitha shoqëritë televizive kanë bërë këtë dhe kjo përben një rezervë në shumën e shpenzimeve të zgjedhjeve.

Gjithashtu janë kontraktuar për konsulencë subjekte të huaja si Barner & Thornburg LLP, CLEAR PATH STRATEGIES LLC, MURPHY VOGEL ASKEW RIELLY LLC dhe OLIVER UBEDA, për konsulencë zgjedhore për të cilat janë paguar dhe kostot përkatëse. Vendosija e tyre si shpenzim që i takon fushatës ose jo është gjykuar nga drejtimi financiar i partisë dhe nëse kemi konfirmuar atë.

Me firmën Barner & Thornburg LLP ishte lidhur një kontratë në shumën 150.000\$ por në fakt u realizua për shumën 100.000\$, shume e cila është paguar dhe njohur në shpenzimet e fushatës. Duke shfrytëzuar një klauzole të kontratës, sipas drejtimit financiar të partisë, kontrata është ndërprerë deri në nivelin e kryer pa penalitete.

Po kështu me konsulentin OLIVER UBEDA është kryer një pagesë me datën 22-06-2017 (ICB-All dhe për mos furnizim shërbimi kjo shumë është kthyer me datë 03-07-2017 (ICB-Euro).

Në shpenzimet e fushates janë përfshirë dhe donacionet për marrjen në përdorim të zyrave elektorale. Këto shpenzim subjektit zgjedhor pohon se është donacion por nuk ka dokumentuar me kontratë dhe faturë. Këto donacione janë vlerësuar me referencë dhe janë njohur në të ardhura dhe shpenzime me vlerësimin e Ekspertëve financiar të monitorimit.

Të gjitha shpenzimet e deklaruara të fushates zgjedhore (përçarje donacioneve) janë të paguara me përjashtim të një fature me TOP CHANNEL sh.a që është likuiduar pjesërisht dhe diferenca prej 3,561,300 lekë është pasqyruar si detyrim kreditor.

Subjekti zgjedhor ka detyrimin e raportimit në KQZ të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore Brenda datës 25 shtator 2017. Ky raportim duhet rideklaruar në përputhje me treguesit që janë pasqyruar me sipër.

Përveç opinionit të dhënë në pjesën e parë, se pasqyra financiare është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimprurese (SKK për OJF-të), po ju paraqesim konkluzionet për përmbushjen e kërkesave specifike të Kodit të Zgjedhjeve, ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar dhe udhëzimeve të KQZ-së, si vijon:

- Burimet e financimit të fushatës zgjedhore janë në përputhje me burimet e lejuara nga Kodi Zgjedhor dhe ligji "Për Partitë Politike" i ndryshuar. Të ardhurat në mjete monetare kanë ardhur vetëm nga buxheti i shtetit dhe nuk janë evidentuar donacione nga persona jo publikë, shoqëri apo individë. Nuk është evidentuar gjithashtu, asnjë shumë e financuar prej organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, në mbështetje të subjektit zgjedhor. Të ardhurat nga donacionet e marra janë kohë televizive të cilat janë dokumentuar me faturë tatimore dhe janë të lejuara nga legjislacioni zgjedhor dhe donacione për marrjen në përdorim të zyrave elektoraleve, si kontribut i individëve të njohura si të ardhura nëpërmjet vlersimit dhe jo nga kontratat dhe faturat e blerjes. Individualisht shuma e vlerësuar e tyre është me e vogël se 100 mijë lekë.
- Detyrimi për regjistrimin i fondeve jopublike në një regjistër të posaçëm, sipas modelit të KQZ-së, dhe nënshkrimim e një deklarate për çdo dhurues, siç është rasti i donacionit në natyrë të qerasë së vlerësuar të zyrave elektorale, nuk është respektuar.
- Kufizimi i Kodit Zgjedhor që shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, (fonde të dhena nga buxheti i shtetit), siç shihet nga të dhënat e pasqyrës së deklaruar është respektuar.
- Detyrimi që çdo shpenzim i kryer për fushatën zgjedhore të dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi është zbatuar për blerjet e mallrave e shërbimeve nga të tretët dhe nuk është respektuar për donacionet në natyrë të rastin e

perdorimit te zyrave elektorale, pasi ato nuk janë të shoqeruara me kontrata dhe fatura të përgatitura nga bleresi.

Baza Kontabël dhe Kufizimi në Shpërndarje

Pavarësisht se baza kontabël e hartimit të pasqyrës financiare mbështetet në SKK për OJF-të, ajo është përgatitur që të përmbushë kërkesat specifike të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ-së) në zbatim te legjislacionit zgjedhor dhe për rrjedhojë mund të mos jetë e përshtatshme për qëllime të tjera. Raporti ynë i drejtohet vetëm Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe Partisë Demokratike dhe nuk duhet t’ju shpërndahet palëve të tjera.

AS-Audit Services sh.p.k

Afrim Suli

Ortaku Kryesor i Auditimit

Tiranë, më 31 Tetor 2017

